

VENDIM
Nr.681, datë 31.3.2008

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV KABLLOR S3”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë” dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Gazmir Marku, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor në fushën e transmetimeve kabllore, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në zonat Vorë, Sukth dhe Marikaj.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

Mesila Doda (Demi)